Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2023/0953

Organi Shqyrtues i Prokurimit përmes Panelit Shqyrtues në përbërje të Vjosa Gradinaj Mexhuani si kryetare, Isa Hasani dhe Vedat Poterqoi si anëtar, duke vendosur mbi ankesën e operatorit ekonomik "Ex Fis" Sh.P.K. të datës 27.11.2023 si dhe mbi ankesën e operatorit ekonomik "Patroni" Sh.P.K. të datës 01.12.2023 kundër Njoftimit mbi Vendimin të datës 15.11.2023 të Autoritetit Kontraktues - "Korporata Energjetike e Kosovës" Sh.A.për anulimin e aktivitetit të prokurimit me titull "Furnizim me lëndë djegëse për kaldajë - Mazut (Fuel Oil 1%)" me numër të prokurimit KEK-23-6766-1-1-1, në bazë të nenit 105 lidhur me nenin 106 dhe nenin 117 të LPP, pas shqyrtimit në seancën pa prezencën e palëve me datë 22.12.2023 merr këtë:

Vendim

I. Refuzohen si të pabazuara ankesa e operatorit ekonomik "Ex Fis" Sh.P.K. me nr. 2023/0953 e datës 27.11.2023 si dhe ankesa e operatorit ekonomik "Patroni" Sh.P.K. me nr. 2023/0967 e datës 01.12.2023 kundër Njoftimit mbi Vendimin të datës 15.11.2023 të Autoritetit Kontraktues - "Korporata Energjetike e Kosovës" Sh.A. për anulimin e aktivitetit të prokurimit me titull "Furnizim me lëndë djegëse për kaldajë - Mazut (Fuel Oil 1%)" me numër të prokurimit KEK-23-6766-1-1-1.

II. Vërtetohet Njoftimi mbi Vendimin të Autoritetit Kontraktues - "Korporata Energjetike e Kosovës" Sh.A. e datës 15.11.2023 për anulimin e aktivitetit të prokurimit me të dhënat si në pikën I të dispozitivit.

III. Urdhërohet konfiskimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar nga operatorët ekonomik ankues bazuar në nenin 31 par. 5 të Rregullores së Punës së OSHP ndërsa mjetet kalojnë në buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

"Korporata Energjetike e Kosovës" Sh.A.në cilësinë e Autoritetit Kontraktues me datë 05.07.2023 ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizim me lëndë djegëse për kaldajë - Mazut (Fuel Oil 1%)" me numër të prokurimit KEK-23-6766-1-1-1. Ky aktivitet i prokurimit është zhvilluar me procedurë të hapur me llojin e kontratës për furnizim dhe me vlerë të parashikuar të kontratës 4,699,056.45€.

Me datë 15.11.2023 Autoriteti Kontraktues ka publikuar Njoftimin mbi Vendimin B58 përmes të cilit ka anuluar aktivitetin e prokurimit duke u arsyetuar me mungesën e ofertave të përgjegjshme.

Me datë 19.11.2023 operatori ekonomik ankues "Ex Fis" Sh.P.K. ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër Njoftimin mbi Vendimin B58 e Autoritetit Kontraktues. Rrjedhimisht me datë 22.11.2023 Autoriteti Kontraktues ka marrë vendim përmes të cilit ka refuzuar si të pabazuar këtë kërkesë për rishqyrtim.Me datë 27.11.2023 operatori ekonomik ankues "Ex Fis" Sh.P.K. ka parashtruar në OSHP ankesën nr. 2023/0953.

Me datë 20.11.2023 operatori ekonomik ankues "Patroni" Sh.P.K. ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër Njoftimin mbi Vendimin B58 e Autoritetit Kontraktues. Rrjedhimisht me datë 22.11.2023 Autoriteti Kontraktues ka marrë vendim përmes të cilit ka refuzuar si të pabazuar këtë kërkesë për rishqyrtim. Me datë 01.12.2023 operatori ekonomik ankues "Patroni" Sh.P.K. ka parashtruar në OSHP ankesën nr. 2023/0963.

Gjatë shqyrtimit paraprak të ankesës, Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesat i përmbajnë të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si të tilla janë parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatorët ekonomik që janë palë të interesuara sipas nenit 4 paragrafit 1 nënparagrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetente për të shqyrtuar këto ankesa sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesave në mënyrë meritore.

Paneli Shqyrtues ka konstatuar po ashtu se nuk ekzistojnë rrethana të konfliktit të interesit në kuptim të nenit 11 të Rregullores nr. 01/2020 të Punës së Organit Shqyrtues të Prokurimit lidhur me nenin 4 paragrafin 1 nënparagrafin 75 të LPP.

Duke marrë parasysh faktin se të dy ankesat janë të ndërlidhura me aktivitetin e njëjtë të prokurimit përkatësisht me njoftimin mbi vendimin e njëjtë të Autoritetit Kontraktues lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, është vendosur që ankesa nr. 2023/0953 dhe ankesa nr. 2023/0963 të bashkohen dhe të trajtohen si rast i unifikuar në kuptim të nenit 16 paragrafit 1 të Rregullores nr. 01/2020 të Punës së Organit Shqyrtues të Prokurimit.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave -

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues "Ex Fis" Sh.P.K. *janë parashtruar përmes ankesës si në vijim: "Veprimi i ZPP për eliminimin e ofertës se OE EXFIS shpk, se pari është ne kundërshtim me DT-ne pjesa e FDT- se Neni 20.2 - Valuta dhe Përshkrimi i Çmimit si dhe drafte kontratën neni 1.3, sepse vlera e këtij tenderi nuk është fikse por indikative dhe se vlera e kësaj kontrate bazohet ne ndryshimet e çmimeve sipas Inkotermi CIF Mediterranean qe kuotohet sipas Platts European Marketscan (Çmimi i Platts-it) dhe mesatarja ditore e kurseve te këmbimit mes Euro dhe Dollarit sipas European Central Bank* (www.ecb.int)*, qe ndryshojnë çdo dite".*

Duke u referuar te pretendimet si më sipër, operatori ekonomik ankues "Ex Fis" Sh.P.K. konsideron se AK ka vepruar në kundërshtim me nenin 1, 7, 24, 27, 56, 59, 60, 69 dhe 72 të LPP.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë 30.11.2023 ka angazhuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe të pretendimeve ankimore të operatorit ekonomik ankues. Me datë 04.12.2023 është pranuar Raporti i Ekspertit Shqyrtues me rekomandimet si në vijim: "*rekomandoj Panelin Shqyrtues që të refuzoj ankesën e operatorit ekonomik si të pabazuar dhe të mbetet në fuqi njoftimi mbi vendimin e AK lidhur me aktivitetin në fjalë*".

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues "Patroni" Sh.P.K.janë parashtruar përmes ankesës si në vijim: "*Sa i përket arsyes së eliminimit se ne kemi ndryshuar dokumentine origjinës së mallit prej OKTA që është dorëzuar në ofertë, me dokumentin Lotus Oiltrade LTD ju sqarojmë se ne nuk kemi bërë asnjë ndryshim material të ofertës dhe të dëshmive që janë ofruar sipas kërkesave të dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë. Ne me dosje të tenderit nuk kemi ofruar asnjë deklaratë për origjinë të mallit prandaj nuk ka asnjë ndryshim sa i përket kësaj dëshmie e cila kërkohet të ofrohet para se të bëhen furnizimet pra pas nënshkrimit të kontratës. Gjatë rivlerësimit AK ka kërkuar sqarime nga ne me pyetjen që të deklarohemi për vendin e origjinës së mazutit dhe prodhuesin. Pyetja ka qenë që të deklarohemi për vendin e origjinës së mazutit dhe prodhuesin, ndërsa ne jemi përgjigjur duke sqaruar se origjina e mazutit do të jetë nga Bullgaria nga prodhuesi Lotus Oil Trade LTD*".

Duke u referuar te pretendimet si më sipër, operatori ekonomik ankues "Patroni" Sh.P.K. konsideron se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 1, 6, 7, 59, 60, 62, 66, 69, 70 dhe 72 të LPP si dhe nenin 43 të RRPP.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë 04.12.2023 ka angazhuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes

dhe të pretendimeve ankimore të operatorit ekonomik ankues. Me datë 04.12.2023 është pranuar Raporti i Ekspertit Shqyrtues me rekomandimet si në vijim: "*rekomandoj Panelin Shqyrtues që të aprovoj pjesërisht si të bazuar ankesën e operatorit ekonomik dhe njëkohësisht të mbetet në fuqi njoftimi mbi vendimin e AK lidhur me anulimin e aktivitetin në fjalë*".

Paneli Shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për të vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore në kuptim të nenit 24 paragrafit 1 të Rregullores së Punës së OSHP duke marrë parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtresat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritor lidhur me rastin.

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportet e ekspertit shqyrtues, mendimet e palëve lidhur me raportet e ekspertit, parashtresat dhe dokumentet e operatorëve ekonomik ankues, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues "Ex Fis" Sh.P.K., *eksperti shqyrtues në raportin e tij ka paraqitur vlerësimet dhe konstatimet si në vijim: "Vlera e planifikuar e aktivitetit te prokurimit ne dosjen e tenderit dhe DNPDF te publikuar ne e-prokurim me date 04.07.2023 ka qenë 4,200,000.00 euro. Me daten 01.12.2023 ju kam drejtuar AK qe te me njoftoj me shkrim lidhur me konfirmimin e mjeteve buxhetore, me daten 04.12.2023 AK ne baze te kërkesës me ka kthyer përgjegjien sqaruese ku ka potencuar se vlera e aktivitetit te inicuar ka qenë 4,200,000.00 euro ku pas analizimit dhe vlerësimit financiar me vendim te bordit janë alokuar mjetet shtese prej 499,058.45 euro, dhe vlera totale e projektit pas shtimit te mjeteve buxhetore arrin në 4,699,058.45 euro. ZKA dhe ZKF konform Nenit 9 te LPP, me anë te nënshkrimit te DNPDF te dates 01.8.2023 kan konfirmuar mjetet financiare me shtesen e alokuar sipas vendimit te Bordit me shumën 499,058.45 euro(shtesë). Nëse kalkulohët vlera e inicuar prej 4,200,000.00 euro + 499,058.45 euro shtesë, totali i projektit to të jetë = 4,699,058.45 euro. Andaj nëse marrim vlerën, shumëne ofertëse se operaotirt ekonomik ankues ,,EX FIS" e cila është 5,066,380.65 euro dhe vleren totale te inicuar nga AK e cila është 4,699,058.45 euro. Diferenca mes inicimit te projektit dhe ofertës se operatorit ekonomik është - 367,322.20 euro. Bazuar dhe mbështetur ne këtë oferta e operatorit ekonomik EX FIS tejkalon shumën e planifikuar te buxhetit te inicuar nga AK për 367,322.20 euro. Duke pasur parasysh këtë ne cilësin e ekspertit shqyrtues konstatoj se AK - KEK gjatë anulimit te procedures se prokurimit është mbështetur ne Nenin 9 dhe Nenin 62 paragrafin 2 pikën 2.1 dhe si rezultat i kësaj ankesa e operatorit ekonomik është është e pa bazuar pasi qe mjetet konfirmimi i mjeteve buxhetore (financiare)i bër nga ZKF dhe ZKA për këtë aktivitet është për 367,322.20 euro më i ulët se sa oferta e OE ankues". Sipas të thënave më sipër, raporti i ekspertit është hartuar në përputhje me autorizimin e Panelit Shqyrtues dhe LPP në fuqi. Eksperti shqyrtues ka trajtuar në mënyrë objektive të gjitha pretendimet e ankuesit "Ex Fis" Sh.P.K.*

Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues "Patroni" Sh.P.K., *eksperti shqyrtues në raportin e tij ka paraqitur vlerësimet dhe konstatimet si në vijim: "Lidhur me këto pretendime ankimore PSH.OSHP ka nxerrur vendimin nr.2023/0563 ku si rezultat i kësaj me qëllim te vërtetimit më sakt te origjinës prodhuesit te Mazutit ka kërkuar qe procedura te kthehet ne rivleresim dhe AK te kërkoj sqarime me te duhura lidhur me origjinen e mazutit dhe prodhuesin e mazutit. Vlen të theksojmë se në ofertën e operatorit ekonomik është dorëzuar edhe një Certifikatë e Kulitetit (Certificate of Quality) me*

Nr.219/2023/RE e datës 19.07.2023, ku thekësohet se vendndodhja (lokacioni) i ngarkimit është HELPE lonia, Thessaloniki kurse ne te nejten certifikatë eshte e cekur edhe prodhuesi OKTA. AK ne baze te kësaj certifikate me qellim te vërtetimit te prejardhjes se prodhuesit te Mazutit ka kekruar edhe sqarimet shtesë. Duke pasur parasysh këtë në cilësinë e ekspertit shqyrtues konstatoj ankesa e operatorit ekonomik është është e pa bazuar pasi që me këtë rast pranimi i një dokumenti me përmbajtje tjetër nga ajo që është dorëzuar në ofertë do të ishte në kundërshtim me nenin 59 paragrafin 2 dhe 4 pika (i) pasi që konsiderohet kusht material. Prandaj bazuar pretendimi ankimore është i pabazuar". Sipas të thënave më sipër, raporti i ekspertit është hartuar në përputhje me autorizimin e Panelit Shqyrtues dhe ligjin në fuqi për prokurimin publik. Eksperti shqyrtues ka trajtuar në mënyrë objektive të gjitha pretendimet e operatorit ekonomik ankues "Patroni" Sh.P.K.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues -

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit. Në këtë mënyrë është gjetur se Autoriteti Kontraktues nuk ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e LPP apo RRPP sikurse pretendohet nga operatorët ekonomik ankues.

Sipas vendimit paraprak 563/2023 paneli kishte konstatuar shkurtimisht si vijon: Paneli konsideron se në procesin e rivlerësimit, kërkohet nga AK që dokumentin e prezantuar nga OE i rekomanduar ta verifikoj ngase i njëjti përmban apo jo të dhëna dhe/ose informacione të qarta mbi prejardhjen dhe prodhuesin e mazutit, gjithnjë që të dy OE pjesëmarrës në këtë aktivitet (*nënkupto:* OE i rekomanduar dhe OE Ankues) n**uk kanë paraqitur një deklaratë të tillë**, kurse si kriter i tillë "deklarata kontestuese" nuk ishte e vendosur në kuadër të kritereve kualifikuese por ishte është kërkuar tek aneksin 1 i DT. Paneli në këtë rast ka konstatuar se mungesa e kësaj deklarate në raport me efektet qenësore të sajë janë konsideruar nga AK si "devijim i vogël" në kuptim të nenit 59.4 lidhur me nenet 8 dhe 9 të LPP, megjithatë sipas gjykimit të tij të pavarur e në vështrim të dispozitave të nenit 1 dhe 6 të LPP, Paneli vlerëson se në këtë rast AK është e obliguar që gjatë procesit të rivlerësimit të aplikojë nenin 52 dhe 72 të LPP për të kërkuar informata shtesë nga ana e OE-të lidhur me origjinën dhe prodhuesin e mazutit, meqë artikulli në rastin konkret e shpreh dhe përcakton qëllimin e prokurimit dhe shfrytëzimin e fondeve publike në ketë rast. Në fakt Paneli konsideron se mungesa e të dhënave të sakta përkitazi me dokumentet e cituara, si të ankuesit po ashtu dhe të operatorit ekonomik të rekomanduar, e vejnë padyshim në dilemë secilin Panel lidhur me faktin nëse vendimi i atakuar duhet mbetur në fuqi, përderisa e gjithë kjo zbrazëtirë informacionesh kanë mundur të mbulohet brenda një kohe efektive.

Pas procedurës së Rivlerësimit, lidhur me ankesën e operatorit ekonomik ankues "Ex Fis" Sh.P.K., Paneli Shqyrtues ka gjetur se pas konfirmimit nga ZKA dhe ZKA të Autoritetit Kontraktues për rritjen e buxhetit fillestar, vlera e parashikuar e kontratës është gjithsej 4,699,058.45 euro. Njëkohësisht Paneli Shqyrtues ka gjetur se operatori ekonomik ankues "Ex Fis" Sh.P.K. ka ofertuar me çmim total prej 5,066,380.65 euro respektivisht ka tejkaluar vlerën e parashikuar të kontratës për 367,322.20 euro.Për këtë arsye, Paneli Shqyrtues i ka falur besimin e plotë sqarimeve të ekspertit shqyrtues sipas të cilave pretendimet ankimore janë të pabazuara.

Lidhur me ankesën e operatorit ekonomik ankues "Patroni" Sh.P.K., Paneli Shqyrtues thekson se lidhur me këtë aktivitet të prokurimit me datë 20.10.2023 është marrë vendimi përmes të cilit

është aprovuar si pjesërisht e bazuar ankesa e operatorit tjetër ankues ("Ex Fis" Sh.P.K.) ashtu që ky aktivitet ishte kthyer në rivlerësim në mënyrë që autoriteti kontraktues të mund të siguroj sqarime shtesë nga operatori ekonomik "Patroni" Sh.P.K. lidhur me çertifikatën e kualitetit përkatësisht origjinën e prodhimit të mazutit që do të furnizohet. Vlen të theksohet se në ofertën e operatorit ekonomik ankues "Patroni" Sh.P.K. është dorëzuar edhe një Çertifikatë e Kulitetit me nr. 219/2023/RE e datës 19.07.2023, ku theksohet se vendndodhja (lokacioni) i ngarkimit është HELPE lonia, Thessaloniki (Selanik) kurse në të njëtën çertifikatë është e cekur edhe prodhuesi OKTA. Autoriteti Kontraktues në bazë të kësaj çertifikate me qëllim të vërtetimit të prejardhjes se prodhuesit të Mazutit ka kërkuar edhe sqarimet shtesë. Në këto sqarime shtesë, Operatori Ekonomik Ankues "Patroni" Sh.P.K. ka deklaruar se prodhuesi është Lotus Oiltrade LTDme origjinë nga Bullgaria. Për këto arsye Paneli Shqyrtues i ka falur besimin konstatimit të ekspertit shqyrtues ku thuhet se "*ankesa e operatorit ekonomik është e pa bazuar pasi që me këtë rast pranimi i një dokumenti me përmbajtje tjetër nga ajo që është dorëzuar në ofertë do të ishte në kundërshtim me nenin 59 paragrafin 2 dhe 4 pika (i) pasi që konsiderohet kusht material. Prandaj bazuar pretendimi ankimor është i pabazuar*".

Përmes nenit 43 paragrafit 43.5 nënparagrafin b) të RRPP është përcaktuar se "*Procedura e prokurimit pas hapjes së ofertave duhet të anulohet nëse asnjëri prej tenderëve të pranuar nuk është i përgjegjshëm*". Duke marrë parasysh të thënat më sipër, Paneli Shqyrtues ka gjetur se në këtë aktivitet të prokurimit të dy operatorët ekonomik ankues të cilët janë edhe tenderuesit e vetëm në këtë rast janë të papërgjegjshëm. Prandaj njoftimi mbi vendimin e autoritetit kontraktues për anulimin e këtij aktiviteti të prokurimit gjen mbështetje në nenin 43 paragrafin 43.5 nënparagrafin b) të RRPP lidhur me nenin 62 të LPP.

Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues, ka gjetur se ankesa e operatorit ekonomik "Ex Fis" Sh.P.K. me nr. 2023/0953 e datës 27.11.2023 si dhe ankesa e operatorit ekonomik "Patroni" Sh.P.K. me nr. 2023/0967 e datës 01.12.2023 duhet të refuzohen si të pabazuara. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur për të vërtetuar Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues "Korporata Energjetike e Kosovës" Sh.A. të datës 15.11.2023 për anulimin e aktivitetit të prokurimit me titull "Furnizim me lëndë djegëse për kaldajë - Mazut (Fuel Oil 1%)" me numër të prokurimit KEK-23-6766-1-1-1.

Panelit Shqyrtueska vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës.

Paneli Shqyrtues kërkon nga Autoriteti Kontraktues që të jetë i vëmendshëm gjatë procedurave të prokurimit publik duke vepruar në përputhje të plotë me LPP dhe legjislacion tjetër në fuqi për prokurimin publik si dhe të veproj në harmoni me të gjeturat e këtij vendimi. Në të kundërtën OSHP mund të inicoj procedurat disiplinore ndaj zyrtarëve përgjegjës të prokurimit.

Për pikën I dhe II të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën III të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 118 të LPP lidhur me nenin 31 paragrafin 5 të Rregullores së Punës së OSHP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kryetar i Panelit Shqyrtues

Vjosa Gradinaj

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- AK - **KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVES sh.a., KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVES sh.a.**
- OE - **Ex Fis, PATRONI SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: